

I nderuar zoti kryetar i Akademisë, i nderuar zoti Ministër i arsimit si edhe anëtarë të Akademisë, miq e të ftuar!

Vij me një emocion të veçantë në këtë seli të nderuar të shkencës së Kosovës. Në këtë Akademi ku rreth 40 vjet më parë, më 1979, im atë Aleks Buda, në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë firmosi të parën Konventë, marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Një akt domethënës jo vetëm si manifestim i frymës iluministe evropiane: që e bukura të triumfojë duhet të kemi akses në arsim, kulturë dhe shkencë. E kuptuar nga të dyja palët (shqiptarë të Shqipërisë dhe të Kosovës) se arti dhe kultura na bën të jemi si entitet kulturor unik, por jo vetëm kaq, u munduan secila palë nga ana e vet, nëpërmjet takimesh kombëtare e ndërkombëtare t'u jepnin një diapazon më të gjerë, me synime politike këtyre marrëdhënieve. Duke folur për marrëdhëniet me Kosovën, shpesh Aleks thoshte: "më dhemb ta them, por në disa aktivitete të përbashkëta që kemi pasur me Kosovën, iniciativën nuk e kemi marrë ne, por kosovarët. Dhe kjo ka të bëjë me politikën që ndiqte qeveria shqiptare, e cila na izolonte nga Kosova nga frika se mos bëheshim titistë, revizionistë".

Mirëpo me vajtjen në Kongresin e Studimeve Ballkanike në Sofje (1966) u krijua një situatë e re. Pjesëmarrës në Kongres midis të tjerëve ishim ne dhe edhe një delegacion kosovar me Idriz Ajetin e Mark Krasniqin etj. do të tregonte Aleks. Por me këta kam qenë njohur që para Luftës II Botërore në Itali, ku ata studionin dhe unë përgatitesha si lektor i gjuhës shqipe pranë profesorit të njohur Carlo Tagliavini në Universitetin e Padovës. Pra pata besim te bashkëpunimi me profesorët nga Kosova, kur ata na kërkuan ndihmë për të mbështetur tezat e tyre gjatë punimeve të Kongresit. Çka u bë në fshehtësi në dy takime në bodrumet e Bibliotekës së Sofjes...Këto kontakte do të zgjeroheshin më vonë me prezantimin e studiuesve të rinj kosovarë shumë premtues.

"Skënderbeu përsëri vazhdon të bashkojë shqiptarët" është titulli i një kapitulli të librit që po promovohet. Me plot mbresa të Aleksit, përshtypje nga pritjet entuziaste prej takimeve me njerëz të ndryshëm në vitin 1968, kur në Prishtinë u mbajt simpoziumi ndërkombëtar për Skënderbeun, që i dha dhe i jep forcë kombit të vet. Ishte rasti për t'u takuar me kolegë, nxënës e studentë me njerëz nga populli jo vetëm në qytete si në Prishtinë, Prizren, Gjakovë po edhe në malësinë e Rugovës etj., me të cilët, siç ka thënë ai, u miqësova aq shumë, sa do ta quaja një fitore të madhe njerëzore. Mendoni sa të gjalla e të forta kanë qenë përshtypjet e tij prej vizitave e takimeve në Kosovë, sa edhe kështu pas kaq vitesh, të transmetuara nga unë në këtë libër janë mbresëlënëse, siç vërejnë recensuesit dhe lexuesit e parë. "Këtu (në Kosovë) më hyri ajo dashuri aq e madhe për vendin dhe kosovarët, që edhe sot e ruaj si një thesar" do të theksonte përsëri Aleks.

Nga ana tjetër edhe unë, tregonte im atë, jam përpjekur diçka të bëj. Mendoj se sadopak kam ndikuar në krijimin e një opinionit pozitiv me shpjegimet për historinë e Kosovës dhe sqarimin rreth miteve që qarkullojnë rreth saj. Në ligjëratat që kam mbajtur në Bon, Sarbryken, Vjenë etj. mbi autoktoninë e Shqiptarëve, apo në bisedat me gazetarë të huaj (Meier, Fon Kohl, Buchala, Erich etj.) edhe studiues apo të tjerë të interesuar për çështjen shqiptare, një pjesë prej të cilëve u bënë mbështetës të çështjes së Kosovës në forumet ndërkombëtare.

Këtu preka disa momente që lidhen me Kosovën, por ka edhe të tjera...Prandaj ju ftoj ta lexoni librin! Sepse, megjithatë fjala e fundit i mbetet opinionit publik, siç ndodh në botimet e reja.

Falënderoj parafolësit për mendimet e shprehura dhe pjesëmarrësit me nderimin që treguan me prezencën e tyre në kujtimin për Aleks Budën dhe librin që u paraqit sot.

Dr. Shk. Tatjana Buda Haxhimihali